



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës- Vushtri

Bazuar në nenin 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040, nenin 31.2 “c” të Statutit të Komunës dhe nenin 7.3 të Udhëzimit Administrativ nr.2008/10 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative në komuna, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.02.2010 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim caktohet lartësia e kompensimit të anëtarëve të Komiteteve Konsultative në Komunën e Vushtrrisë, për pjesëmarrje në mbledhje, si vijon:

- ❖ Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Rini, Sport dhe Fe.....30 €
- ❖ Komiteti Konsultativ për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.....30 €
- ❖ Komiteti Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....30 €
- ❖ Komiteti Konsultativ për Ekonomi dhe Shërbime Publike.....30 €

Neni 2.

Anëtarët e Komiteteve Konsultative nuk mund të kompensohen për më shumë se 6 (gjashtë) mbledhje brenda 1 (një) viti kalendarik.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Sekretaria e Komunës.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit në mbledhje të Kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës- Vushtri

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika c nenin 40 paragrafi 2 pika a, lidhur me pikën g, po të njejtit nen të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe nenin 31, paragrafi 2 pika a, g të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.02.2010 mori këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim plotësohet Rregullorja për tarifa, ngarkesa dhe gjyba komunale 01 Nr.742/08, më 30.12.2008.

Neni 2.

Në nenin 3, paragrafi 1 të rregullores së lartshënuar, shtohet pika 20, me sa vijon: Neni 3.1.20 Certifikata e shtetësisë1 €.

Neni 3.

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorinë për Administratë – Sektori i Statusit Civil.

Neni 4.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga Kuvendit i Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Kuvendi i Komunës- Vushtrri

Bazuar në nenin 17 "r" dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe nenin 31.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.02.2010, merr këtë:

V E N D I M

Neni 1.

Me këtë vendim iu ipen në shfrytëzim të përkohshëm pa kompensim Organizatës Rinore "**Duga**" – Prelluzhë, Organizatës Rome "**Romano anglinipe**" -Prelluzhë, dhe Radiostacionit Lokal "**Mix Radio**" poashtu nga Prelluzha, dy hapësira për zyra, në Shtëpinë e Kulturës në fsh. Prelluzhë, kati përdhes, për zhvillim të aktiviteteve kulturore dhe rinore.

Neni 2.

Hapësirat e cekura si në nenin paraprak iu ipen për shfrytëzim të përkohshëm në afat prej 3 vitesh me mundësi të vazhdimit të këtij afati.

Neni 3.

Marrësit në shfrytëzim të këtyre hapësirave obligohen të i kryejnë të gjitha obligimet për shpenzimet komunale që kanë të bëjnë me harxhimet e energjisë elektrike, të ujit, mbeturinave dhe shpenzimeve tjera eventuale komunale të cilat do të i krijojnë gjatë punës së tyre.

Neni 4.

Dhënia në shfrytëzim mund të atyre hapësirave mund të ndërpritet në çdo kohë nëse;

- ❖ Një gjë të tillë e kërkojnë interesat e komunës.
- ❖ Marrësi në shfrytëzim nuk i përmbahen rregullave dhe kodit të mirësjelljes me rastin e shfrytëzimit të atyre hapësirave,
- ❖ Nuk i përmbushin në mënyrë të rregullt dhe me kohë obligimet e shpenzimeve komunale, të rrymës, ujit, mbeturinave dhe obligimeve tjera në bazë të ligjit.

Neni 5.

Autorizohet Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport që të lidhë kontratë për shfrytëzim të atyre hapësirave konform të cekurave në këtë vendim dhe në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 6.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi



Republika e Kosovës



Komuna - Vushtrri

01Nr. 36/10
Më; 25.02.2010

Bazuar në nenin 27 “d”, 24 dhe 40.2 “c” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 si dhe nenin 31.2 të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 25.02.2010 merr këtë:

V E N D I M

Neni 1

Me këtë vendim, mjetet financiare nga të hyrat vetanake të buxhetit të Komunës të vitit 2009 në shumë të përgjithshme prej 317.771.27 €, barten në vitin 2010.

Neni 2

Shpërndarja e mjeteve në shumën e cekur si në nenin paraprak do të bëhet në bazë të tabelarit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi dhe i bashkangjitur në shtojcë.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit në mbledhje të kuvendit dhe nënshkrimin nga kryesuesi i kuvendit.

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi